



REPUBLIKA E KOSOVËS-REPUBLIKA KOSOVA-REPUBLIC OF KOSOVO  
KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS  
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA  
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO



Pranuar / Dorezuar Prilijenat/Prodato Received/Delivery	05-04-2023	3 vit 3 years	
Organ /Njesia Organ /Jedinica Org./Unit	Nr Prot br Prot Prot No	Shtesa Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKPUSAK	3326/2023		113



## Republika e Kosovës Republika Kosova-Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS  
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA  
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVA

A.nr.393/2023

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Ardi Haxhnikaj-Demi, kryetare, Eshref Shabani dhe Malsore Gashi-Bajraktari anëtarë, me Ilire Mehmeti-Shaqiri-Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional, në cilësinë e procesmbajtëses, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.393/2023 të datës 22.02.2023 të parashtruar nga ankuesi nga Lipjani, kundër organit të punësimit/Komuna e Lipjanit, në çështjen juridike "kompensim material", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nënparagrafin 1.1, nenin 16 paragrafi 3 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës si dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur më datën 04.04.2023, njëzëri mori këtë:

### V E N D I M

*Refuzohet si e pabazuar* ankesa me numër A.nr.393/2023 e datës 22.02.2023, e parashtruar nga ankuesi

### A r s y e t i m

Nëpunësi civil, i punësuar në Komunën e Lipjanit, më datë 22.02.2023 ka parashtruar ankesë me numër protokollit 1972/2023 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër përgjigjes me shkrim të datës 08.02.2023 të Udhëheqësit të Personelit në Komunën e Lipjanit, lidhur me refuzimin e kërkesës së ankuesit për kompensim në mënyrë retroaktive të mjeteve të papaguara në emër të diferencës së koeficienti të pagës nga gjashtë (6) në tetë (8) nga data 20.11.2014 deri me datën 31.01.2023.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave, me datë 28.02.2023 ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë në Komunën e Lipjanit. Ndërsa Këshilli, me datë 08.03.2023 përmes e-mailit ka pranuar përgjigjen në ankesë së bashku me shkresat e bashkëngjitura të lëndës.

*Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave ka administruar këto prova:* Ankesën me numër të protokollit 1972/2023 të datës 22.02.2023; Kërkesën me numër të protokollit 1-120/046984 të

datës 08.02.2023; Përgjigjen në kërkesë me numër të referencës 1-120/04-6984 të datës 08.02.2023; Akt emërimit e datës 02.04.2012; Shkresën me numër të protokollit 6038 të datës 27.11.2014 të DASHC/MAP-04/1571; Kërkesën për përgjigje në ankesë të datës 28.02.2023; Përgjigjen në ankesë të datës 08.03.2023; Përshkrimin e detyrave të punës të datës 11.08.2010; Listën e pagave për muajin dhjetor-2022; Listën e pagave për muajin janar-2023; Vendimin me numër A.nr. 1107/2022 të datës 19.01.2023 të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbim Civil të Kosovës;

Kolegji i Këshillit duke u bazuar në vlerësimin e hollësishëm të çdo prove veç e veç dhe të gjitha provave të marra së bashku, si dhe bazuar në rezultatin tërësor të shqyrtimit administrativ, konstatoi së ankesa e ankuesit është e pabazuar, sepse:

Nga provat e administruara të lëndës rrjedhë së ankuesi është i punësuar në Komunën e Lipjanit në pozitën e punës *Inspektor i Tregut*. I njëjti më datë 07.12.2022 kishte parashtruar ankesë për harmonizimin e koeficientit të pagës nga koeficienti gjashtë (6) në koeficientin tetë (8) në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, ndërsa ky i fundit me Vendimin A.nr.1107/2022 të datës 19.01.2023 ka përfunduar procedurën administrative lidhur me ankesën e ankuesit, me arsyetimin se duke marr parasysh se pretendimet ankimore të ankuesit kanë pas për objekt çështjen e realizmit të koeficientit të pagës, Kuvendi i Republikës së Kosovës, me datë 22.12.2022 ka aprovuar Ligjin Nr.08/L-196 për Pagat në Sektorin Publikë, i cili parasheh rregulla dhe kushte tjera për përcaktimin e pagës të të punësuarve në sektorin publik, duke përfshi edhe koeficientet dhe nivelet e koeficienteve të pagës të cilat ndryshojnë nga rregullat dhe sistemi aktual i pagave.

Ankuesi më datë 08.02.2023 ka parashtruar kërkesë tek Udhëheqësi i Personelit të Komunës së Lipjanit për kompensimin e diferencës së dy koeficienteve të pagës në mënyrë retroaktive gjegjësisht për periudhën nga data 20.11.2014 deri me datë 31.01.2023. Udhëheqësi i Personelit përmes përgjigjes së datës 16.02.2023 ka refuzuar kërkesën e ankuesit të datës 08.02.2023 me arsyetimin se Zyra e Personelit, nuk është kompetent për ndryshimin e koeficientit, pasi që ndryshimi i koeficientit mund të bëhet vetëm me zhvillimin e procedurave të rekrutimit siç është parapare me ligj.

I pakënaqur me përgjigjen e datës 08.02.2023 të Udhëheqësit të Personelit të Komunës së Lipjanit, ankuesi me datë 22.02.2023 parashtron ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me pretendimin ankimor për njohjen e të drejtës për kompensimin e diferencës së koeficientit të pagës nga gjashtë (6) në tetë (8), për periudhën nga data 20.11.2014 deri me 31.01.2023.

Kolegji i Këshilli, shqyrtoj pretendimin ankimor të ankuesit lidhur me kompensimin e diferencës së koeficientit të pagës në mënyrë retroaktive dhe si rrjedhojë konstatoi se pretendimi ankimor i ankuesit si i tillë nuk është i bazuar, ngase sipas shkresave të administruara të lëndës rrjedh së ankuesi me datë 02.04.2012 ka nënshkruar pa vërejtje aktin e emërimit për pozitën e punës "*Inspektor i tregut*" me koeficient të pagës gjashtë (6), dhe se i njëjti edhe përkundër faktit se ka qenë në dijeni lidhur me koeficientin e përcaktuar të pagë, nuk ka ndërmarr asnjë veprim juridik në kuptim të harmonizimit të koeficientit të pagës me vendin e punës deri me datë 07.12.2022, duke vepruar kështu në kundërshtim me dispozitat e Ligjit Nr.02/L-28 për Procedurën Administrative (*ligj ky i aplikueshëm në kohën kur ankuesi kishte nënshkruar aktin e emërimit me datë 02.04.2012*), përkatësisht nenin 130 të këtij ligji ku përcaktohej se: 130.1. Ankimi administrativ bëhet brenda 30 ditësh nga dita kur: a) ankuesi ka marrë njoftim për aktin ose për refuzimin për të nxjerrë aktin.



Theksuar si me sipër, e duke u bazuar në nenin 18 paragrafi 1 nënparagrafi 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbiqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

**Këshillë juridike:** Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit. Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

## KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS

Lënda me numër A.nr.393/2023

Ilire Mehmeti-Shaqiri

Procesmbajtëse

Vendimi i dërgohet:

- Ankuesit
- Udhëheqësit të Burimeve Njerëzore në Komunën e Lipjanit; dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së



Ardita Flaxhnikaj-DEMI

Kryetare e Kolegjit

